



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2256, datë 23.01.2013

Për

“Miratimin e Dokumentit rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren Nr. 7, datë 23.12.2008 “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes””.

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

| | | | |
|---------|--------|------------|---------|
| 1. Z. | Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. | Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. | Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. | Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. | Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.01.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e Dokumentit rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren Nr. 7, datë 23.12.2008 “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes””

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja t) e nenit 8, pika 1 e nenit 114 dhe neni 115 të ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr.9918**);
2. Neni 120 dhe neni 129 i ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**KPrA**), i ndryshuar;
3. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.370, datë 5.6.2003 Për miratimin e strategjisë “Për shërbimin e radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë” (**VKM 370**).
4. Pika 2 e nenit 22 të Rregullores Nr. 7, datë 23.12.2008 “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes” (**Rregullore Nr. 7**), miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it, Nr. 522, datë 23.12.2008.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- Projekt Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Projekt-Dokumenti rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren Nr. 7, datë 23.12.2008 “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes””;

si dhe, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, me qëllim përmbushjen sa më të plotë dhe eficiente të detyrimeve ligjore që duhet të zbatojnë subjektet e interesuara, për t’u pajisur me licencë “Për stacionet radio të anijes”, çmon si të rëndësishme ndryshimet dhe shtesat në aktin Rregullore Nr. 7, datë 23.12.2008 “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes”, me qëllim përcaktimin e rregullave procedurale për t’u pajisur me licencë nëpërmjet modulit të aplikimeve online;
2. Grupi i punës i caktuar me Urdhërin nr. 900, datë 30.10.2012 ka hartuar ndryshimet dhe shtesat në projekt aktin administrativ Rregulloren Nr. 7, datë 23.12.2008 “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes”, me qëllim përcaktimin e rregullave procedurale për kryerjen nëpërmjet modulit të aplikimeve online nga subjektet e interesuara për tu pajisur nga AKEP me licencë;
3. Ndryshimet dhe shtesat për përcaktimin e rregullave procedurale në Rregulloren Nr. 7, datë 23.12.2008 “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes”, janë mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi si dhe rekomandimeve të ITU-së, duke patur parasysh dhe implementuar objektivat rregullatore të AKEP;
4. Ndryshimet dhe shtesat e propozuara në Rregulloren Nr.7 nga Grupi i Punës, për t’u zbatuar nga subjektet e interesuara për licencë, nëpërmjet modulit të aplikimeve online, bëhen pa ndryshuar përmbajtjen, objektin, qëllimin dhe kërkesat e përfshira në këtë rregullore si dhe me qëllim përmiresimi për:
 - Kalimin e aplikimit për licencë “Për stacionet radio të anijes” nëpërmjet modulit të aplikimeve online;
 - Realizimin e procedurës së paisjes me licencë në një kohë sa më të shkurtër, në një mënyrë më të thjeshtuar me rregulla praktike;
 - Shkurtimin e procedurave të përpunimit të dokumentacionit në AKEP duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj subjekteve;
 - Realizimin e një procesi transparent në kufijtë e veprimit të Autoritetit Publik;
5. Për licencën “Për përdorimin e stacionit radio të anijes”, që aplikimet për rinovim licence të mos bëhen vit për vit, dhe duke marrë në konsideratë faktin që të dhënat që plotëson subjekti në licencë janë në përgjithësi të pandryshueshme për të cilat subjekti ka mundësinë të aplikojë online, propozohet që vlefshmeria e licencës të bëhet nga 1 (një) vit që është aktualisht, në 5 (pesë) vjet.
6. Për këtë qëllim, AKEP në zbatim të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, në kuadër të transparencës dhe paanësisë çmon si të arsyeshme miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në përcaktimin e rregullave procedurale për kryerjen nëpërmjet modulit të aplikimeve online nga subjektet e interesuara për licencë, të projekt aktit

administrativ Rregullore Nr. 7, datë 23.12.2008 “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes””;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, duke konsideruar rëndësinë e miratimit të këtij projekt akti administrativ, për subjektet e interesuara për pajisjen me licencë “Për stacionet radio të anijes”, bazuar në shkronjën t) të nenit 8, pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918,

V E N D O S:

1. Të miratojë Dokumentin rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në “Rregulloren Nr. 7, datë 23.12.2008, Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes” sipas Aneksit 1 bashkëlidhur;
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë nga data e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

**I. Ndryshime dhe shtesa në Rregulloren Nr.7, datë 23.12.2008,
“Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes”.**
(Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr.522, datë 23.12.2008).

A. Pika 1 e nenit 3, ndryshon dhe bëhet:

**Neni 3
Baza ligjore**

1. AKEP, nxjerr këtë rregullore në mbështetje të gjurmës p) dhe t) të nenit 8 dhe pikës 6 të nenit 64 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**) i ndryshuar, si dhe Strategjinë “Për shërbimin e Radiondërlidhjes detare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me Vendimi të Këshillit të Ministrave Nr. 370, datë 05.06.2003 (**VKM Nr. 370**).

B. Pika 1 dhe pika 2 e nenit 5, ndryshojnë dhe bëhen:

**Neni 5
Formulari i aplikimit**

1. Subjekti që kërkon të pajiset me licencë për përdorimin e stacioneve radio të anijes duhet të aplikojë online sipas formularit të aplikimit të përcaktuar në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje, i cili shoqërohet me tabelën mbi të dhënat teknike dhe deklaratën e pronarit/personit të autorizuar.
2. Formulari i aplikimit online plotësohet tek Moduli i Aplikimit Online për licencë “Për stacionet radio të anijes” në faqen web të AKEP www.akep.al.

C. Shtohet pika 5 dhe pikat 1, 2, 3 të nenit 6, ndryshojnë dhe bëhen:

**Neni 6
Dhënia e Licencës**

1. Licenca i jepet të interesuarit brenda 7 (shtatë) ditëve nga data që ka dërguar online në AKEP Formularin e aplikimit të plotësuar në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore dhe pasi të ketë kryer të gjitha pagesat përkatëse për marrjen e licencës.
2. Kur AKEP konstaton parregullsi në plotësimin e Formularit të aplikimit të depozituar, i kërkon subjektit rregullimin e tyre brenda një periudhe prej 5 (pesë) ditësh pas marrjes së njoftimit online, për parregullsitë e konstatuara.
3. Trajtimi i kërkesës online bëhet nga Drejtoria përkatëse në AKEP dhe Licenca lëshohet e nënshkruar nga Kryetari.

4. Formulari i aplikimit online nënshkruhet nga subjekti në momentin e tërheqjes së Licencës dhe i bashkëngjitet praktikës që arkivohet në AKEP.

D. Pika 1 dhe pika 2 e nenit 12, ndryshojnë dhe bëhen:

Neni 12 Çregjistrimi

1. Çregjistrimi bëhet nëpërmjet njoftimit online për rastet kur:
 - (a) anija shitet në një shtet tjetër,
 - (b) anija mbytet,
 - (c) anija bëhet e papërdorëshme,
 - (ç) anija është jashtë shërbimit, për një kohë 2 ose më shumë vjet.
2. Mbajtësi i Licenses ka detyrim të njoftojë online AKEP-in për rastet e mësipërme.

E. Pika 1 dhe pika 2 e nenit 18, ndryshojnë dhe bëhen:

Neni 18 Modifikimi i licencës

1. Modifikimi i licencës bëhet me kërkesën online të subjektit, në rastet kur:
 - (a) ndryshon emri i anijes,
 - (b) kërkohet të ndryshohen ose shtohen pajisjet radio,
 - (c) çdo ndryshim tjetër në të dhënat e licensës.
2. I licencuari është i detyruar të njoftojë online në AKEP për të gjitha ndryshimet në të dhënat e deklaruara në formularin e aplikimit.

F. Pika 1 e nenit 19, ndryshon dhe bëhet:

Neni 19 Detyrimet Financiare

1. Subjekti, me marrjen e njoftimit online nga AKEP për miratimin e licencës së kërkuar, është i detyruar që të paguajë detyrimet financiare të parashikuara për licencën në përputhje dhe zbatim të legjislacionit në fuqi, akteve nënligjore dhe rregullave të përcaktuara nga AKEP.

G. Pikat 1 dhe 2 te nenit 20, ndryshojnë dhe bëhen:

Neni 20 Vlefshmëria e licencës dhe rinovimi

1. Licenca e lëshuar nga AKEP sipas kësaj rregulloreje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e hyrjes në fuqi të saj.
2. Për rinovimin e licencës, subjekti i drejtohet AKEP-it duke dërguar online kërkesën 1(një) muaj para përfundimit të vlefshmërisë së saj, duke paraqitur dhe ndryshimet, nëse ka të tilla.

H. Ne Aneksin 1 – Formulari i aplikimit online, me qëllim përcaktimi të formës së aplikimit dhe përshtatjen me kërkesat e modulit online për të pajisur aplikantin me “përdorues”, “fjalëkalim” dhe “kod konfirmimi”, janë shtuar:

1. Forma e aplikimit:

| | |
|--------------------------|--------------------------------|
| <input type="checkbox"/> | Aplikim për licencë |
| <input type="checkbox"/> | Rinovimi i licencës egzistuese |

| | |
|--------------------------|--|
| <input type="checkbox"/> | Ndryshimi i të dhënave |
| <input type="checkbox"/> | Ndërprerje aktiviteti/ veprimtarie (Çregjistrim) |

2. Tek të dhënat e subjektit:

- Emri i Personit (juridik/fizik);
- Emri i përfaqësuesit ligjor;
- Numri personal sipas dokumentit të identifikimit – ID.

3. Informacion shtesë:
